

"Tring TV" Sh.a

Rr "RRUGA E QELQIT", Tirane

Shenime per Deklarimet Financiare

Periudha 1 Janar deri 31 Dhjetor 2019

## 1. Organizimi, Objekti dhe Kontributet, Pronesia mbi aktivet, Kapitali dhe Administrimi

### Organizimi

Shoqeria "Tring TV" sh.a eshte krijuar si shoqeri aksionere, me aksioner te vetem me Vendim Gjykate Nr. 32591 dt.20/12/2004. Me date 02/12/2008 kryhet regjistrimi i aplikimit prane QKR-se ne ane te te cilit jane depozituar Vendimet e Asamblese se pergjithshme te ortakeve date 24/11/2008 dhe 25/11/2008 te cilet bejne ndryshimin e statusit dhe emrit te shoqerise nga "Theatre International" sh.p.k ne "Tring TV" sh.a., si dhe shoqeria nga shoqeri me ortak te vetem, kthehet ne shoqeri me tre aksionere.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit Nr.25/2018 dt.10.05.2018 Per Pasqyrat Financiare. nga statuti i saj dhe legjislacioni ne fuqi.

### Objekti dhe Kontributet

Shoqeria "Tring TV" sh.a zhvillon aktivitetin e saj :- ne fushen e ndertimit dhe te tregtimit te sistemeve te Telekomunikacionit dhe Transmetimeve Televizive te cdo lloji (tokesor me kablo ose satelitor ne forme te koduar apo te pakoduar), tregtimin e aparaturave per sistemet e transmetimit dhe te marrjes se valeve televizive, prodhim transmetim, ritransmetim dhe shitjen ne menyre dixhitale te produkteve dhe sherbimeve audio e video, prodhimin, tregtimin dhe shperndarjen te programeve te ndryshme radio-televizive si dhe video audio kasetave ne formate te ndryshme profesionale ose jo dhe prodhimin e shitjen e spektakleve televiziv, shfaqjeve teatrale, dokumentareve televiziv, reklamave, filmave artistik me metrazh te shkurter te mesem dhe te gjate, filmave vizatimor , programeve audio vizual te cdo lloji, dublimin dhe titrimin e filmave te huaj e shqipetar, per vende te tjera etj. si dhe shperndarjen e tyre ne Shqiperi dhe jashte kufijve te saj.

Kontributi ne shoqeri perfaqesohet nga kapitali i tre aksionereve si me poshte:

-Znj. Ridvana Dulaku	34% te aksioneve,
-Znj. Holta Dulaku	33% te aksioneve
-Znj. Melina Dulaku	33% te aksioneve.

### Pronesia mbi Aktivet

Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne ambiente zyra me qira. Aktivet e saj perbehen nga aparatura teknike dhe informatike, makineri e pajisje pune, mobilje dhe orendi, mjete transporti dhe inventar ekonomik.

### Kapitali

Kapitali i shoqerise prej 250,000,000 leke eshte kapitali i nenshkruar i regjistruar prane QKR-se me Certifikaten e Kryerjes se Regjistrimive date 02/12/2008.

Kapitali paraqitet si me poshte:

	Vlere Nominale Aksioni	Nr. Aksioneve	%	Kapital Nenshkruar
Ridvana Dulaku	10,000	34,000	34	85,000,000
Holta Dulaku	10,000	33,000	33	82,500,000
Melina Dulaku	10,000	33,000	33	82,500,000
Total		100,000	100%	250,000,000

"Tring TV" sh.a.  
SHQIPËRI

“Tring TV” Sh.a

Rr “RRUGA E QELQIT”, Tirane

Shenime per Deklarimet Financiare

Periudha 1 Janar deri 31 Dhjetor 2019

---

### **Administrimi**

Shoqeria drejtohet nga Keshilli i Administrimit i cili perbehet nga administratori i pare dhe dy administratore te tjere ligjore . Administratoreve i perkasin te gjitha kompetencat per drejtimin ekzekutiv te pergjithshem.

Keshilli i administrimit i perbere nga tre administratore me Administratore e pare Znj. Ridvana Dulaku dhe Administratore te tjere Z. Artan Dulaku dhe Z. Sotiraq Toshi.

Shoqeria per vitin 2019 ka patur nje numur mesatar punonjesish prej 98 te punesuar

## **2. Politikat kryesore kontabile**

### **2.1 Bazat e pergatitjes**

Deklarimet financiare te bashkangjitura jane pergatitur ne baze te rregjistrimeve kontabel te mbajtura per qellime te kontabilitetit te vendit konform Ligjit 9228 date 29 Prill 2004 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”. Pasqyrat Financiare te fund vitit jane paraqitur ne formatin e paraqitur ne Standartet Kombetare te Kontabilitetit ne fuqi (SKK 2).

Sipas parimeve te kontabilitetit ne Shqiperi deklarimet financiare jane pergatitur mbi bazen e konceptit te te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara.

Pergatitja e pasqyrave Financiare ne perputhje me kerkesat e SKK, kerkon perdorimin e disa vleresimeve kontabile te rendesishme. Kjo gjithashtu kerkon qe manaxhimi i Shoqerise te jape gjykimin e saj mbi zbatimin e politikave kontabile te saj. Fushat te cilat kerkojne nje shkalle te larte ose komplekse te gjykimit ose ato per te cilat vleresimet apo supozimet jane te rendesishme per hartimin e pasqyrave financiare paraqiten ne shenime.

Shpenzimet qe lidhen me te ardhurat e fituara gjate periudhes raportuese njihen ne te njejten periudhe kontabel si dhe te ardhurat perkatese.

Shpenzimet e kryera gjate nje periudhe raportuese, qe ndryshon nga periudha kur ato i sjellin perfitime njesise ekonomike raportuese, rregjistrohen si shpenzime pikerisht ne periudhen kur merren perfitimet.

Mbajtja e kontabilitetit, i cili perfshin si regjistrimet kontabel dhe sistemin e tij, mbahen ne menyre te kompjuterizuar, me ane te nje programi te kontabilitetit.

Deklarimet financiare jane shprehur ne Leke, e cila eshte monedha shqiptare.

Nje permbledhje te pjeses me te madhe te politikave kontabel mbi bazen e te cilave jane pergatitur deklarimet financiare jane paraqitur sa me poshte:

### **2.2 Instrumentat financiare**

Kompania ka vetem instrumenta financiare jo derivative, perfshire dhe kerkesa nga kliente dhe kerkesa te tjera, mjete likuide dhe te ngjashme me to, huamarrje dhe huadhenie, furnitore dhe te tjera detyrime.

Instrumentat financiare jo-derivative njihen, fillimisht, me vleren e drejte plus, çdo kosto te drejtperdrejte transaksioni te lidhura me to, pervec atyre te pershkruara me poshte. Ne vazhdim te njohjes fillestare instrumentat financiare vleresohen si me poshte.

Nje instrument financiar njihet nese kompania eshte pale ne kushtet e kontrates. Aktivet financiare nuk njihen nese te drejtat e Kompanise mbi rrejdhat e ardhshme te parase te gjeneruara nga aktivi financiar kane mbaruar ose nese kompania i transferon aktivite financiare nje pale te trete pa mbajtur te drejtat e kontrollit ose ne thelb te gjitha rreziqet dhe perfitimet nga aktivi. Blerja dhe shitja normale e aktiveve financiare kontabilizohet ne daten e shitblerjes psh. daten ne

"Tring TV" Sh.a

Rr "RRUGA E QELQIT", Tirane

Shenime per Deklarimet Financiare

Periudha 1 Janar deri 31 Dhjetor 2019

te cilen kompania vendos vete te bleje apo te shese aktivet. Detyrimet financiare nuk njihen me, nese detyrimet e Kompanise te specifikuara ne kontrate mbarojne afatin ose shlyen ose anulohen.

#### *Mjetet Monetare*

Zeri para ne dore dhe te ngjashme perfshin parate ne dore, depozita rrjedhese ne banka, te tjera investime afatshkurtra shume likuide me afat maturimi tremujor ose me pak.

#### *Kerkesa per t'u arketuar*

Kerkesat per t'u arketuar afatshkurtera jane paraqitur ne bilanc me kosto te amortizuar, pra me vleren e koston se tyre minus provizionet e krijuara per renie ne vlere. Provizione te lejuara mund te llogariten, per shumat e vleresuara si te rikuperueshme, ne fitim humbje kur ekziston nje evidence objektive qe keto kerkesa jane zhvleresuar me pare.

#### *Detyrime te pagueshme*

Detyrimet per tu paguar dhe te tjera detyrime paraqiten me vleren e drejte te tyre dhe me pas maten me vleren e tyre te amortizueshme.

#### *Huate bankare dhe te tjera*

Ne vazhdim te njohjes fillestare, huate bankare dhe te tjera paraqiten me kosto te amortizueshme duke njohur çdo diference midis koston dhe vleres se rikuperueshme ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve gjate periudhes se huamarrjes ne baze te nje interesi efektiv.

#### *Te tjera*

Te tjera instrumenta financiare jo-derivative maten me kosto te amortizueshme duke perdorur metodën e interest efektiv, minus çdo humbje nga zhvleresimi.

Kontabilizimi i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare sqarohet ne piken 2.8.

Aktivitetet financiare klasifikohen si detyrime afatshkurtra pervec rasteve kur kompania ka te drejte te pakushtezuar te ndryshoje marreveshjen e huase per te pakten 12 muaj pas dates se bilancit.

### **2.3 Inventaret**

Inventaret maten fillimisht me kosto. Pas njohjes fillestare te tyre Shoqeria vlereson inventarin me vleren me te ulet midis koston dhe vleres neto te realizueshme. Vlera neto e realizueshme i referohet vlerës neto që njësisë ekonomike raportuese pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhën normale të biznesit.

Inventaret i nenshtrohen testit te zhvleresimit ne daten e mbylljes se bilancit. Shuma e Zhvleresimit njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve atehere kur ka faktore objektive qe tregojne qe inventaret jane zhvleresuar.

### **2.4 Aktivitet Afatgjata Materiale**

Ne bilanc AAM paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.

Aktivitet Afatgjata Materiale jane vleresuar me koston e blerjes dhe kosto te tjera te drejtperdrejta qe lidhen me sjelljen e aktivitetit ne kushtet e nevojshme per funksionimin e tij.

Metoda per llogaritjen e amortizimit eshte mbi bazen e metodes zbritese.

Toka dhe Ndertimet ne Proces, si dhe parapagimet furnitoreve nuk amortizohen.

"Tring TV" sh.a.

"Tring TV" Sh.a

Rr "RRUGA E QELQIT", Tirane

Shenime per Deklarimet Financiare

Periudha 1 Janar deri 31 Dhjetor 2019

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashte perdorimit percaktohen nga krahasimi i perfitimeve me vleren e tyre kontabel. Keto perfshihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

### 2.5 Aktivet Afatgjata Jo-Materiale

Ne bilanc AAJM paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.

Aktivete Afatgjata Jo Materiale jane vleresuar me koston e blerjes.

Metoda per llogaritjen e amortizimit eshte mbi bazen lineare.

### 2.6 Kuotat e kapitalit

Kuotat e aksioneve njihen si kapital. Aksionet njihet me vleren nominale 2,500 leke secila.

### 2.7 Zhvleresimi i aktiveve jo financiare

Vlerat kontabile te aktiveve jofinanciare te Kompanise, pervec inventareve dhe tatimeve te shtyra rishikohen ne cdo date raportimi per te pare nese ka ndonje tregues per zhvleresim. Nese ekziston ndonje tregues i tille atehere vleresohet vlera e rikuperueshme e aktivitet.

Humbja nga zhvleresimi njihet nese vlera kontabile e nje aktivi eshte me e madhe se vlera e rikuperueshme e tij. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne fitim ose humbje.

Vlera e rikuperueshme e nje aktivi eshte me e madhja mes vleres se tij ne perdorim dhe vleres se drejte minus koston e shitjes. Ne matjen e vleres ne perdorim, flukset e pritshme te parase skontohen ne vleren e aktuale duke perdorur normen e skontimit perpara takses qe paraqet vleresimin e tregut per vleren ne kohe te parase dhe riskun specifik te aktivitet.

Per humbjet nga zhvleresimi te njohura ne periudhat e meparshme vleresohet ne cdo date raportimi nese ka ndonje tregues sipas te cilit humbja eshte ulur ose nuk ekziston me. Nje humbje nga zhvleresimi anulohet nese kane ndodhur ndryshimet ne vleresimet e bera per percaktimin e vleres se rikuperueshme. Nje humbje nga zhvleresimi anulohet deri ne ate mase qe vlera kontabel e aktiveve te mos kaloje vleren kontabel te aktiveve, minus amortizimin, qe do te ishte percaktuar nese zhvleresimi nuk do te kishte ndodhur.

### 2.8 Zhvleresimi i aktiveve financiare

Nje aktiv financiar zhvleresohet nese ekzistojne tregues sipas te cileve nje ose disa ngjarje kane pasur nje ndikim negativ ne vleresimin e fluksesve te ardhshme te parase prej atij aktivi. Humbja nga zhvleresimi ne rastin e nje aktivi financiar te vleresuar me kosto te amortizuar llogaritet si diference midis vleres kontabel (neto) dhe Vleres aktuale te fluksesve te pritshme te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Aktive financiare te nje rendesie te vecante testohen per zhvleresim ne menyre te vecante. Pjesa tjeter e aktiveve vleresohen se bashku, ne grupe qe kane karakteristika te ngjashme te riskut. Te gjitha humbjet nga zhvleresimi njihen ne fitim ose humbje.

Humbja nga zhvleresimi mund te anulohet nese ajo mund te lidhet objektivisht me nje ngjarje te ndodhur pasi njohjes se zhvleresimit. Per aktivet financiare te vlersuara ne kosto te amortizuara anulimi i zhvleresimit njihet ne fitim humbje.

### 2.9 Njohja e te ardhurave

Te ardhurat jane hyrje bruto te perfitimeve ekonomike gjate periudhes, te cilat vijne nga veprimtaria e zakonshme e nje njesie ekonomike kur keto hyrje sjellin rritje ne kapitalin neto, pervec rritjeve qe lidhen me kontributet nga pjesemarrësit ne kapital. Te ardhurat perfshijne vetem vleren e drejte te perfitimeve ekonomike te marra dhe ato qe jane per t'u marre nga shitja e mallrave dhe sherbimeve gjate aktivitetit te zakonshem te Kompanise.

"Tring TV" sh.a.  
TIRANË, SHQIPËRI



**“Tring TV” Sh.a**  
**Rr “RRUGA E QELQIT”, Tirane**  
**Shenime per Deklarimet Financiare**  
**Periudha 1 Janar deri 31 Dhjetor 2019**

Te ardhurat perfshijne shumat neto pa perfshire shumat e mbledhura per llogari te palëve të treta si taksat e shitjes, taksat e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, si dhe tatimi i vlerës së shtuar, te cilat nuk janë përfitime ekonomike që hyjnë në njësine ekonomike dhe nuk sjellin rritje të kapitalit neto.

Ne lidhje me shitjen e mallrave, te ardhurat jane njohur kur ndryshimi i pronesise se bashku me riskun qe vjen nga ky ndryshim, jane transferuar tek bleresi.

## **2.10 Shpenzimet**

### *Shpenzimet*

Shpenzimet jane njohur mbi bazen e te drejtave te konstatuara. Shpenzimet per kerkime e zhvillime pergjithesisht jane ngarkuar ne llogarine e shpenzimeve ne periudhen se ciles i perkasin.

## **2.11 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Te ardhurat financiare permbledhin te ardhurat nga interesi nga fondet e depozituara ne banka, fitimet nga shitja aktiveve financiare te mbajtura per shitje, si dhe fitimet nga kembimet valutore. Te ardhurat nga interesi njihen si detyrime atehere kur perdoret metoda e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare paraqesin shpenzimet per interesat nga huate, humbjet nga kembimet valutore, si dhe humbjet nga zhvleresimet a aktivave financiare. Gjithe kostot e huamarrjeve njihen ne humbje fitime mbi bazen e perdorimit te metodës se interesit efektiv.

## **2.12 Tatimi mbi fitimin aktual dhe i shtyre**

Shpenzimi (e ardhura) tatimore përmban shpenzimin tatimor aktual (të ardhurën tatimore aktuale) dhe shpenzimin tatimor të shtyrë (të ardhurën tatimore të shtyrë). Shpenzimet qe lidhen me tatimin mbi te ardhurat paraqitet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve pervec rasteve kur ai lidhet me zerat e kapitalit dhe ne kete rast paraqitet direkt ne kapital.

Shpenzimi tatimor aktual eshte shuma e tatimit qe pritet te paguhet bazuar ne te ardhurat e vitit ushtrimor, shkallen tatimore qe zbatohet ne dite e raportimit si dhe cdo korrigjim te detyrimeve tatimore te viteve paraardhese. Tatimi i shtyre njihet duke perdorur metoden e pasivit të bilancit, duke marre si diference te perkohshme diferencat midis bazës tatimore të një aktivi ose pasivi dhe vlerës së tij kontabël neto në bilanc. Tatimi i shtyre llogaritet duke u bazuar ne shkallen tatimore, te percaktuar nga ligjet qe jane ne fuqi, qe pritet te jete e zbatueshme ne momentin kur diferenca e perkohshme do te zhduket.

Kompania njej aktivin për tatim të shtyrë vetëm për aq sa është e mundur që fitimet e tatueshme të ardhshme jenë të disponueshme kundrejt të cilave të mund të përdoret aktivi tatimor i shtyrë. Vlera kontabël e një aktivi tatimor të shtyrë duhet të rishikohet në çdo datë të bilancit. Një njësi ekonomike do të zvogëlojë vlerën kontabël të një aktivi tatimor të shtyrë për aq sa nuk ka më mundësi që fitim i tatueshëm i mjaftueshëm të jetë i disponueshëm për të lejuar përfitimin e përdorimit të një pjese ose i të gjithë atij aktivi tatimor të shtyrë. Çdo zvogëlim i tillë do të rimerret deri në masën që bëhet i mundur disponimi i fitimit të tatueshëm të mjaftueshëm.

## **2.13 Transaksionet me monedhat e huaja**

### *(a) Monedha e perdorur dhe raportuese*

Zerat e perfshire ne pasqyren financiare te seciles prej njesive ekonomike te grupit maten ne monedhen baze te mjedisit ekonomik ne te cilen njesia ekonomike vepron (monedha ne



“Tring TV” Sh.a  
 Rr “RRUGA E QELQIT”, Tirane  
 Shenime per Deklarimet Financiare  
 Periudha 1 Janar deri 31 Dhjetor 2019

perdorim). Pasqyrat e financiare raportohen ne Leke (ALL), e cila eshte monedha e perdorur dhe raportuese e Kompanise.

*(b) Transaksionet dhe Gjendjet*

Transaksionet ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen e perdorur duke perdorur kurset e kembimit ne daten e kryerjes se transaksionit. Fitimet dhe humbjet qe rezultojne nga kryerja e transaksioneve ne monedhe te huaj dhe nga konvertimi i aktiveve monetare dhe detyrimeve ne monedhe te huaj me kursin e kembimit te fund-vitit njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e kembimit me te rendesishme jane :

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Euro	121.77	123.42
USD	108.64	107.82

**Aktive Afatshkurter**

**3.Mjete Monetare**

Perfaqeson gjendjen ne banke dhe ne arke me 31.12.2019 si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Para ne dore	88,352	1,146,790
Para ne Banka	31,379,080	9,980,264
<b>Totali</b>	<b>31,467,432</b>	<b>11,127,053</b>

Likuiditetet jane paraqitur ne bilanc me gjendjen e llogarise bankare ne daten e fundit te 31 Dhjetorit 2019, e cila eshte e njejte me ekstraktin e fundit te bankes per kete periudhe si dhe llogarite ne valute jane konvertuar me kursin e Bankes Shqiperise per kete date.

**4. Aktive te tjera afat shkurtra financiare**

Llogaria Aktive afatshkurter financiare perfaqeson detyrime per tu arketuar pas dates 31.12.2018 si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Kerkesa te arketueshme	464,439,570	474,624,197
Llogari/Kerkesa te tjera te arketueshme	2,342,809	2,688,406
<b>Totali</b>	<b>466,782,379</b>	<b>477,312,603</b>

4a Kerkesa te arketueshme perfaqeson klientet si me poshte:



“Tring TV” Sh.a  
 Rr “RRUGA E QELQIT”, Tirane  
 Shenime per Deklarimet Financiare  
 Periudha 1 Janar deri 31 Dhjetor 2019

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Kliente te vitit	302,380,788	446,881,676
Kliente mbi nje vit	162,058,781	27,742,521
<b>Totali</b>	<b>464,439,570</b>	<b>474,624,197</b>

4b Kerkesa te tjera te arketueshme perbehen si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Detyrime tatimore ne ndjekje	0	711,327
Garanci te dhena	464,250	443,844
Parapagesaa ne dogane	50,505	22,207
tvsh Leasing e llogaritur	1,388,183	510,148
Parapagime te mara	439,872	7,476
<b>Totali</b>	<b>2,342,809</b>	<b>1,695,002</b>

### 5. Inventari

Shoqeria ka ne dispozicion inventare te cilat perfaqesojne gjendjen e inventarit te mallrave te shoqerise me date 31/12/2019 si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Mallra	52,397,316	31,082,788
Iventar I imet	814,266	814,266
Parapagime te dhena	31,295,044	101,658,826
<b>Totali</b>	<b>84,506,626</b>	<b>133,555,881</b>

Inventaret jane vleresuar me koston e marjes se tyre. Parapagimet e dhena perfaqesojne parapagimet per furnizimin e mallit dhe te sherbimit.

6.Parapagime dhe shpenzime te shtyra perfaqesojne vleren e shpenzimeve te shtyra te cilat do te shperndahen ne periudhat e ardhshme.

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Parapagime dhe shpenzime te shtyra	818,391,228	873,065,528
<b>Totali</b>	<b>818,391,228</b>	<b>873,065,528</b>

“Tring TV” Sh.a  
 Rr “RRUGA E QELQIT”, Tirane  
 Shënime për Deklarimet Financiare  
 Periudha 1 Janar deri 31 Dhjetor 2019

**7. Aktive te Afatgjata**

*7.a Aktive Afatgjate Materiale* Shoqeria ka nje vlere neto aktive afatgjate materiale e cila perbehet si me poshte:

	Makineri e pajisje pajisje pune	Mjete Transporti	Pajisje zyresh informatike	Mobilje orendi	Pajisje te Tjera	Totali
<i>Aktive te Trupezuara</i>						
Gjendje 01.01.2019	627,161,904	22,907,173	37,974,788	20,622,558	25,731,927	734,398,350
Shtesa	6,443,430	7,388,242	3,588,722	1,610,570	4,550,241	23,581,206
Pakesime						0
Gjendje 31.12.2019	<b>633,605,334</b>	<b>30,295,415</b>	<b>41,563,510</b>	<b>22,233,128</b>	<b>30,282,168</b>	<b>757,979,556</b>
<i>Amortizimi</i>						
Gjendje 01.01.2019	22,886,993	4,971,008	2,589,218	1,505,342	1,700,521	33,653,082
Shtesa	3,424,077	4,411,127	705,451	359,116	828,841	9,728,612
Pakesime						0
Gjendje 31.12.2019	<b>26,311,070</b>	<b>9,382,135</b>	<b>3,294,669</b>	<b>1,864,458</b>	<b>2,529,362</b>	<b>43,381,693</b>
<i>Vlera neto 01.01.2019</i>	604,274,912	17,936,165	35,385,570	19,117,216	24,031,406	700,745,269
<i>Vlera neto 31.12.2019</i>	<b>607,294,264</b>	<b>20,913,280</b>	<b>38,268,841</b>	<b>20,368,670</b>	<b>27,752,807</b>	<b>714,597,863</b>





"Tring TV" Sh.a  
 Rr "RRUGA E QELQIT", Tirane  
 Shenime per Deklarimet Financiare  
 Periudha 1 Janar deri 31 Dhjetor 2019

7 b. *Aktivet Afatgjata Jomateriale* detajohen si me poshte:

	Te drejta transmetimi	Licensa	Totali
<i>Aktive te Trupezuara</i>			
Gjendje 01.01.2019	285,182,911	4,627,797	289,810,708
Shtesa		772,128	772,128
Pakesime			0
Gjendje 31.12.2019	<u>285,182,911</u>	<u>5,399,926</u>	<u>290,582,837</u>
<i>Amortizimi</i>			
Gjendje 01.01.2019	25,357,908		25,357,908
Shtesa			0
Pakesime			0
Gjendje 31.12.2019	<u>25,357,908</u>	<u>0</u>	<u>25,357,908</u>
<i>Vlera neto 01.01.2019</i>	<u>259,825,003</u>	<u>4,627,797</u>	<u>264,452,800</u>
<i>Vlera neto 31.12.2019</i>	<u>259,825,003</u>	<u>5,399,926</u>	<u>265,224,929</u>

Ne aktivet afatgjata jomateriale perfshihen te gjitha te drejtat e transmetimit dhe licensat qe shoqeria ka blere per ti transmetuar per nje periudhe me te madhe e se nje vit.

7c *Aktivet Financiare* paraqisin vleren e pjesemarrjes ne shoqeri te tjera

Ne aktiv te bilancit paraqiten te gjitha aktivet per te cilen shoqeria ka titull pronesie, se ato paraqiten te vleresuara me vleren e tyre te hyrjes ne shoqeri, klasifikimi i tyre ne elemente te veçante eshte ne perputhje me rregullat e percaktuara nga ligji "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Per te gjitha ndryshimet ne Aktive te Qendrueshme ekziston dokumentacioni perkates.

8. **Pasivet Afatshkurtra** ne detajohen si me poshte:

**Huate dhe parapagimet** ne detajohen si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Hua Bankare Overdraftet	103,672,268	120,560,264
Te pagueshme ndaj furnitoreve	262,820,033	370,828,817
Te pagueshme ndaj punonjesve	19,385,476	16,187,630
Detyrime tatimore	16,933,078	11,758,752
Parapagime te arketuara	0	3,216,784
<b>Totali</b>	<u>402,810,855</u>	<u>522,552,246</u>

Hua Bankare perfaqesojne overdraftet dhe llogarite negative te Bankes

“Tring TV” Sh.a  
Rr “RRUGA E QELQIT”, Tirane  
Shenime per Deklarimet Financiare  
Periudha 1 Janar deri 31 Dhjetor 2019

8a Te pagueshmet ndaj Furnitoreve detajohen si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Furnitore te Vitit	149,954,675	328,166,785
Furnitore mbi nje vit	112,865,358	42,662,032
<b>Totali</b>	<b>262,820,033</b>	<b>370,828,817</b>

8 b. Detyrimet tatimore:

Llogarite e detyrimeve fiskale paraqiten me shumen per t’u paguar si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
TVSH	13,171,742	7,185,646
Tatim Fitimi	1,704,071	2,853,827
Sigurime shoqerore& TAP	2,057,265	1,719,279
<b>Totali</b>	<b>16,933,078</b>	<b>11,758,752</b>

Detyrimet fiskale jane llogaritur konform legjislacionit perkates.

Parapagime te arketuara perfaqesojne vleren e te ardhurave te shtyra (shitjet e abonimeve ose kartave gervishtese qe u takojne periudhave te tjera fiskale) te cilat do te shperndahen ne periudhat e ardhshme.

9. Pasivet Afatgjata detajohen si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Kredi Bankare	74,477,067	46,058,736
-Raifeisen Bank	51,800,208	13,576,180
-Cerdins Bank	13,873,322	28,927,160
-Raifeisen Leassing	637,722	937,903
-Tirana Factoring Leassing	8,165,816	3,176,719
- Parapagese Leasing	0	(559,227)
Mardhenie me grupin	1,837,786,378	1,849,010,244
<b>Totali</b>	<b>1,912,263,445</b>	<b>1,895,068,980</b>

10. Kapitalet e veta perfaqeson kapitalin themeltar te regjistruar ne QKR ne vlere 250,000,000 leke, humbjen e mbartur dhe fitimin neto te periudhes kontabel detajuar me poshte:



“Tring TV” Sh.a  
 Rr “RRUGA E QELQIT”, Tirane  
 Shenime per Deklarimet Financiare  
 Periudha 1 Janar deri 31 Dhjetor 2019

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Kapitali i paguar	250,000,000	250,000,000
Fitimi / Humbja e pashperndare	-208,355,497	-249,573,177
Fitimi / Humbja Rezultati i Ushtrimi	24,251,653	41,217,680
	<u>65,896,156</u>	<u>41,644,503</u>

**11. Shitje neto.**

Shitjet neto detajohen si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Shitje Abonime	159,455,828	122,619,817
Shitje kontenti	742,288,486	573,296,045
Te ardhura nga sherbimet	281,055,541	272,121,958
<b>Totali</b>	<u>1,182,799,855</u>	<u>968,037,820</u>

**12. Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit** perfaqeson shitje si transport per te trete qe nuk jane objekt i drejtperdrejte i veprimtarise se shoqerise.

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Te ardhura te tjera Revista	2,843,200	2,698,400
<b>Totali</b>	<u>2,843,200</u>	<u>2,698,400</u>

**13 Shpenzime per lende te para dhe sherbime.**

Shpenzimet per mallra detajohen si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Kosto mallit shitur	72,214,225	143,881,551
<b>Totali</b>	<u>72,214,225</u>	<u>143,881,551</u>

**14. Shpenzime te personelit.**

Ne kete ze perfshihen shpenzime si me poshte.

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Paga	67,606,948	64,740,934
Sigurime shoqerore	10,286,960	9,648,074
<b>Totali</b>	<u>77,893,908</u>	<u>74,389,008</u>

“Tring TV” Sh.a  
 Rr “RRUGA E QELQIT”, Tirane  
 Shenime per Deklarimet Financiare  
 Periudha 1 Janar deri 31 Dhjetor 2019

**15.Shpenzime te tjera.**

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Shpenzime te tjera	20,501,934.00	21,444,052.00
Sherbim nga te trete	37,175,021	12,215,958
Qera	14,913,862	11,252,619
Mirembajtje dhe riparime	21,749,675	3,392,454
Prime dhe sigurime	1,209,377	3,408,078
Licensa dhe koncesione	8,115,184	10,258,409
Konsulence ligjore	4,054,343	2,399,357
Shpenzime zyre	2,630,097	2,637,537
Pritje dhe perfaqesime	2,947,028	
Penalite& shpenz pa dokumenta	32,138,523	4,306,198
Te drejta transmetimi	694,666,620	673,138,144
Transferime udhetim dieta	609,141	726,728
Shpenzime postare dhe telekom	37,873,010	10,385,215
Taksa vendore, tatime te ndryshme	4,534,850	6,490,716
Shpenzime energji	9,499,296	10,849,373
Shpenzime transporti	1,810,789	4,039,706
Reklame publicitet	110,487,911	22,873,044
Sherbime bankare	14,914,319	8,276,978
<b>Totali</b>	<b><u>1,019,830,981</u></b>	<b><u>797,735,032</u></b>

Tarifa e auditimit per vitin eshte 480,000 leke pa tvsh.

**16.Shpenzime Financiare.**

Ne kete ze perfshihen te ardhura dhe shpenzime si me poshte.

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Fitim nga kembime valutore	17,474,733	136,446,088
Te ardhuranga interest e demshperblime	19,842,288	65,558
Te ardhura te tjera	0	1,194,555
Shpenzim nga kembime valutore	(2,188,604)	(16,354,613)
Shpenzime per interesa	(6,900,888)	(12,756,562)
<b>Totali</b>	<b><u>28,227,529</u></b>	<b><u>108,595,027</u></b>



“Tring TV” Sh.a  
Rr “RRUGA E QELQIT”, Tirane  
Shenime per Deklarimet Financiare  
Periudha 1 Janar deri 31 Dhjetor 2019

**17. Fitimi/Humbja Neto**

Fitimi neto eshte llogaritur si me poshte.

	<u>Viti 2019</u>		<u>Viti 2018</u>
Fitim Bruto	34,202,860	0	49,251,306
Shpenzime te pa njohura	32,138,523		4,306,198
Baza llogaritjes Tatimit	66,341,383		53,557,503
% e tatim Fitimit	15%		15%
<b>Tatim Fitimi</b>	<b>9,951,207</b>		<b>8,033,625</b>
<b>Fitimi NETO</b>	<b>24,251,653</b>		<b>41,217,680</b>

*Te ardhurat ne krahasim me raportimet ne Formularin e Deklarimit te pageses tvsh nuk rakordojne si me poshte:*

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Te ardhurat ne FDP	1,182,426,271	965,185,223
Mbyllje paradhenie	3,216,784	5,552,331
Parapagim te mara	0	0
Diferenc		(1,334)
<b>Totali Sipas Bilancit</b>	<b>1,185,643,055</b>	<b>970,736,220</b>

**18 Ngjarje pas dates se mbylljes se bilancit**

Që nga 31 dhjetori 2019, përhapja e COVID-19 ka patur ndikim të rëndësishëm në shumë ekonomi lokale në mbarë globin. Në shumë vende, bizneset po detyrohen të ndërpresin ose kufizojnë operacionet për periudha të gjata ose të pacaktuara kohore. Masat e marra për të ngadalësuar përhapjen e virusit, të cilat përfshijnë ndalimet e udhëtimit, karantinat, distancimin shoqëror dhe mbylljen e shërbimeve jo thelbësore, kanë shkaktuar ndërprerje të konsiderueshme për bizneset në të gjithë botën, duke rezultuar në një ngadalësim ekonomik. Qeveritë dhe bankat qendrore janë përgjigjur me ndërhyrje monetare dhe fiskale për të stabilizuar kushtet ekonomike. Edhe Qeveria e Shqipërisë ka marrë një sërë masash në kuadër të ngadalësimit të përhapjes së virusit të cilat përfshijnë shtyrjen e kësteve të kredive për tre muaj për bizneset dhe individët të cilët kanë patur vështirësi ekonomike për shkak të masave të marra për ngadalësimin e përhapjes së virusit, shtyrjen e pagesave të qirave për tre muaj, si dhe një sërë masash për ndalimin e bizneseve që konsiderohen jo thelbësore dhe me rrezik për përhapjen e sëmundjes dhe kufizimin e lëvizjes së lirë të njerzve brenda fashave orare të përcaktuara.

Shoqeria ka përcaktuar që këto ngjarje janë ngjarje pas datës së bilancit të cilat nuk kërkojnë korigjime. Prandaj, pozicioni financiar dhe rezultatet e aktiviteteve më dhe për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2019 nuk janë korigjuar për të pasqyruar ndikimin e tyre. Kohëzgjatja

“Tring TV” Sh.a

Rr “RRUGA E QELQIT”, Tirane

Shenime per Deklarimet Financiare

Periudha 1 Janar deri 31 Dhjetor 2019

dhe ndikimi i pandemisë COVID-19, si dhe efektiviteti i përgjigjeve të qeverisë dhe bankës qendrore, mbetet i paqartë në këtë kohë. Nuk është e mundur të vlerësohet me besueshmëri kohëzgjatja dhe ashpërsia e këtyre pasojave, si dhe ndikimi i tyre në pozicionin financiar dhe rezultatet e Shoqërisë për periudhat e ardhshme.

Drejtimi i shoqërisë nuk është në dijeni të ndonjë ngjarjeje tjetër pas datës së aprovimit të pasqyrave financiare e cila mund të kërkojë rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Nuk ka ngjarje të cilat kanë ndodhur pas datës së raportimit dhe që mund të kërkojnë rregullime apo informacione shtesë nga drejtimi i shoqërisë në lidhje me këto Pasqyra Financiare.

### 19 VIJIMESIA

Shoqëria deklaron se nuk ka probleme me vijimesine

**Administratori**  
Ridvana Dulaku



**Financieri**

